



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 467/1 Prot.

Tiranë, më 02.03.2026

VENDIM

Nr. 14, Datë 02/03/2026

PËR

MIRATIMIN E RREGULLOREVE DHE KRITEREVE TË KONKURSIT TË PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2027-2028, TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në zbatim të nenit 3, nenit 38, pika 1, germa (d), neni 74 e në vijim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 319, datë 13.09.2022 “Për miratimin e Statutit të UART”, të Statutit të UART, i ndryshuar, neni 40, pika 1, germa (h), neni 87, pikat 7,8,9, neni 92, pikat 7,8,9, neni 96, pikat 7,8,9, neni 100, pikat 6,7,8, shkresës së FM-së me nr. 467 prot., datë 27.02.2026, pasi diskutoi mbi rregulloret dhe kriteret e konkursit të pranimit për vitin akademik 2027-2028 të Fakultetit të Artit Skenik, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë “Bachelor” dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”, “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregulloreve dhe kriterëve të konkursit të pranimit për vitin akademik 2027-2028 të Fakultetit të Artit Skenik, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë “Bachelor” dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”, “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Rregulloret dhe kriteret e konkursit të dërgohen zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit, në QSHA si dhe të përditësohen në portalin U-Albania.
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të UART, së bashku me rregulloret dhe kriteret e konkurseve të pranimit të miratuara për vitin akademik 2027-2028 të Fakultetit të Artit Skenik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA



Prof. Arben LLOZI



Prof. Miltiadh KUTALI



Prof. Sadik SPAHIJA



Prof. Lorenc RADOVANI



Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA



Prof. Rudina CIKO



Prof. Gazmend GJOKA



Prof. Asoc. Dorian ÇENE




Prof. Asoc. Albes FUSHA



Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI


Prof. Asoc. Kristina LAÇO



Prof. Asoc. Genci FUGA



Prof. Asoc. Alet ÇELOALIAJ



Prof. Asoc. Orion SHIMA



Enea TRIMI (Student FAB)



Rei KITA (Student FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
DEKANATI

Nr. 464 Prot.

Tiranë, më 27/02/2026

Lënda: Mbi dorezimin e Rregulloreve dhe kriteret e konkursit për vitin akademik 2027 – 2028.

ZV./REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof.Asoc. Dorian CENE

Z. Dorian!

Bashkëngjitur po ju dërgojmë Rregulloret dhe kriteret e konkursit për vitin akademik 2027 – 2028 për të dy ciklet e studimit “Bachelor” dhe “Master i Arteve”.

DEKANI

Prof. Miltiadh KUTALI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RREGULLORE

PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT

NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË

“BACHELOR”

NË FAKULTETIN E ARTIT SKENIK,

NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

PËR VITIN AKADEMIK 2027 – 2028

MIRATUAR ME VENDIM NR 14, DATË 02/03/2026

TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 74, Pranimi në ciklin e parë të studimeve, si dhe mbështetur në Rregulloren e UART të ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, konkurset e pranimit në Fakultetin e Artit Skenik për vitin akademik 2027-2028 do të zhvillohen si më poshtë:

Neni 1

Pranimi i kandidatëve

- 1.1 Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Artit Skenik në Universitetin e Arteve, bëhet me konkurs. Rezultati me pikë i konkurseve të pranimit që zhvillohen pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit sipas kësaj Rregulloreje si dhe kritereve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve sëbashku me rezultatet me pikët e Maturës Shtetërore përbëjnë rezultatin përfundimtar.
- 1.2 Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3 Për zgjedhja e tyre është e ndërruar nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë posaçërisht për trojet Shqiptare.
- 1.4 Pikët e vlerësimit për çdo konkurrent do të ndahen sipas vendimeve të Senatit Akademik dhe Udhëzimeve të MAS.

Neni 2

Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

- 2.1 Dekani i Fakultetit merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Pranimit për çdo program e Studimi.
- 2.2 Përbërja e Komisionit të Pranimit të Programit të Studimit shpallet në ditën e fillimit të konkursit.
- 2.3 Në përbërjen të Komisionit të Pranimit aktivizohen:
 - I. Titullarë të fushës përkatëse,
 - II. Pedagogë efektivë të Departamenteve përkatëse,
 - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës për ato programe studimi ku nuk mund të mbulohen nga pikat I, II të këtij Neni.
- 2.4 Në përbërje të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë bërë konsultime private lidhur me konkursin e pranimit apo janë në konflikt interesi.
- 2.5 Në ambientet ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga Titullari i Fakultetit të Artit Skenik.
- 2.6 Për monitorimin e të gjithë procedurave të konkurrit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, Rektori i UART, me Urdhër të posaçëm ngre grupin përkatës, i cili monitoron zhvillimi e të gjithë procedurave të konkurrit në Fakultetin e Artit Skenik. Po ashtu konkursi monitorohet dhe nga përfaqësuesit e MAS.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 3

Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurrit.

- 3.1 Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së dërguar nga Ministria e Arsimit Sportit.
- 3.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.
- 3.3 Konkursi për Fakultetin e Artit Skenik do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit, të përcaktuara për këtë qëllim nga Dekani i Fakultetit.
- 3.4 Lejohen të hyjnë në konkurs vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurrim, të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi si më poshtë:
 - I. Kartë Identiteti ,
 - II. Pasaportë për jashtë shteti.
 - III. Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente identifikimi nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.
- 3.5 Kandidati konkurrent për të hyrë në konkurs duhet të paraqesë në hyrje edhe mandat pagesën e bërë në llogari të Universitetit të Arteve. Kjo e bazuar në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- 3.6 Në varësi të specifikave për secilin Program Studimi komisionet do të punojnë paradite dhe pasdite me paraqitjet individuale të kandidatëve, duke i bërë të ditura më parë oraret përkatëse. Oraret duhet të shpallen në ambientet e Fakultetit të Artit Skenik.
- 3.7 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe ambientet e zhvillimit të tyre do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve në ambientet e Fakultetit të Artit Skenik. Ky kalendar shpallet në Fakultet një javë përpara fillimit të konkursit.
- 3.8 Ditën e parë të konkursit pasi të jenë sistemuar në ambientet e zhvillimit të tij, kandidatëve u komunikohen rregullat e konkurrit. Kjo bëhet nga Kryetarët e komisioneve përkatëse.
- 3.9 Sekretaria mësimore ju dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të Programit të Studimit të gjitha materialet për konkurs, si dhe listat e konkurrentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 3.10 Bazuar në kriteret për secilin Program Studimi, komisionet krijojnë hapësirën kohore të nevojshme për shpërfaqjen individuale të kandidatëve gjatë konkurrit.

Neni 4

Kriteret e konkursit të pranimit për ciklin e parë Bachelor

Programi i Studimit: AKTRIM

Kandidatët e Programit të Studimit Aktrim duhet të interpretojnë përpara komisionit të pranimit materialet e mëposhtme:

1. Tregim
2. Poezi
3. Monolog (i zgjedhur nga vetë kandidati konkurues)
4. Monolog nga dramaturgjia klasike botërore si Rasin, Kornej, Molier, Shekspir etj.
(I detyruar)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5. Një fabul ose anekdotë
 6. Bashkëbisedim mbi njohuritë e letërsisë dhe teatrit shqiptar dhe botëror.
 7. Bashkëbisedim mbi njohuritë e kinematografisë shqiptare dhe botërore.
- (Koha në dispozicion për paraqitjen e materialeve të kandidatit për student është 30 min.)

Koha e zgjatjes së konkurimit në programin e studimit Aktrim është në varësi të numrit të kandidatëve pjesëmarrës.

Programi i Studimit: REGJI

Gjatë zhvillimit të konkursit kandidatit i kërkohet nga komisioni i pranimit:

- Hartimi i një **skicë platforme regjisoriale** mbi bazën e një pjesë dramatike që caktohet aty për aty nga komisioni (tema, *konflikti, personazhet, dekor, imazhi regjisorial etj.*)
 - Bashkëbisedimi mbi **formimin e përgjithshëm kulturor** në fushën e teatrit, dramaturgisë, filmit, letërsisë në përgjithësi, arteve figurative etj.
- (Koha në dispozicion të kandidatëve është 5 orë, një ditë.)

Interpretimi i materialeve të mëposhtme:

- a) **Monolog**
- b) **Tregim**
- c) **Poezi**

(Koha në dispozicion të kandidatëve është 5 orë, një ditë.)

Etydin regjisorial mbi bazën e një teme të caktuar që sugjerohet aty për aty nga komisioni.
(Koha në dispozicion të kandidatëve është 5 orë, një ditë.)

Konkursi në programin e studimit regjisurë zhvillohet në tre ditë.

Koha e zgjatjes së konkurimit në programin e studimit Regji është në varësi të numrit të kandidatëve pjesëmarrës.

Gjithashtu kandidati i nënshtrohet edhe kërkesave të tjera plotësuese që jepen nga komisioni i pranimit.

Programi i Studimit: SKENOGRAFI – KOSTUMOGRAFI

Kandidati duhet t'i nënshtrohet këtyre kërkesave:

- Realizimi i një modeli të kompozuar nga natyra në vizatim ose pikturë.
(koha: 5 orë, një ditë.)
- Krijimi i një **projekti skenografik ose kostumografik**. (koha: 5 orë.)
- **Testimi teorik me shkrim** mbi formimin e përgjithshëm kulturor dhe profesional në fushën e teatrit, letërsisë dhe muzikës (në *formimin profesional duhet të ketë njohuri teorike për specifikën e skenografisë, kostumografisë, pikturës, vizatimit dhe Historisë së Arteve Figurative.*) (koha: 45 minuta.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Konkurenti duhet të paraqesë **dosjen personale** e cila duhet të ketë kompozime në skenografi, kostumografi, pikturë, vizatim etj. Dosja dorëzohet ditën e fundit të konkursit, mbi të cilën do të bëhet bashkëbisedimi me komisionin. (koha 30 minuta)

Konkursi në programin e studimit skenografi-kostumografi zhvillohet në tri ditë.

SHËNIM: Telajot, letrat, bojrat do të përballohen nga vetë kandidati.

Programi i Studimit: KOREOGRAFI

Konkursi do të zhvillohet me një fazë dhe do të ketë këto kërkesa :

- Ushtrime klasike, (klasë baleti) (koha: 90 minuta)
- Demonstrim i një variacioni nga baletet e ndryshme botërore dhe shqiptare. (koha: 90 minuta)
Kompozim nga kandidati për ndërtimin e një motivi klasik si dhe popullor me ritme 2/4; 3/4; dhe ritme të përziera. (koha: 60 minuta) **(një ditë)**
- Ekzekutimi i një pantomime sipas kërkesës së komisionit. (koha: 60 minuta)
- Përgatitja e një libreti koreografik dhe demonstrimi i gjuhës shprehëse të personazheve (Tema jepet nga komisioni). (koha: 260 minuta, një ditë)
- Bashkëbisedim rreth njohurive teorike e praktike mbi Folklorin Koreografik Shqiptar (koha: 60 minuta)
- Bashkëbisedim rreth njohurive mbi Historinë e Baletit Shqiptar dhe Botëror. (koha: 60 minuta një ditë)

Konkursi në programin e studimit koreografi zhvillohet në tri ditë.

Koha e zgjatjes së konkurimit në programin e studimit Koreografi është në varësi të numrit të kandidatëve pjesëmarrës.

Programi i Studimit: REGJI FILMI DHE TV

Kandidatët për këtë specialitet duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

- Hartimin e një skicë – platforme regjisoriale në bazë të një tregimi, novele apo historie të shkurtër që caktohet aty për aty nga komisioni pranues. (tema, *konflikti, karakteret, skenografia, imazhi regjisorial*) (koha: 240 minuta)
- Bashkëbisedim mbi formimin kulturor në fushën e kinematografisë shqiptare dhe botërore, zhanret e filmit, letërsisë në përgjithësi, muzikës, artet figurative etj. (koha: 60 minuta,) **(një ditë)**
- Njohuri për përdorimin e aparatit fotografik me film. (si *opsion mund të jetë dhe aparati digital*) (koha: 300 minuta, **një ditë**)
- Etydin regjisorial mbi baza fotografie të një teme që sugjerohet nga komisioni aty për aty. (koha: 300 minuta) **(një ditë)**



Konkursi në programin e studimit regji filmi dhe televizioni zhvillohet në tre ditë.

Koha e zgjatjes së konkurimit në programin e studimit regji filmi dhe televizioni është në varësi të numrit të kandidatëve pjesëmarrës.

Kandidati duhet të disponojë gjatë zhvillimit të konkursit një aparat fotografik.

SHËNIM: Të gjithë të interesuarit për sqarime të mëtjshme të paraqiten pranë Sekretarisë së Fakultetit

Neni 5

Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

- 5.1 Vlerësimi për paraqitjen individuale të çdo kandidati bëhet nga Komisioni i Pranimi të Programit të Studimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohet nga Dekani i Fakultetit.
- 5.2 Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre).
- 5.3 Gjatë paraqitjes individuale të kandidatëve, anëtarët e jurisë mbajnë shënimet përkatëse. Po ashtu çdo anëtar i jurisë ka të drejtë t'i drejtojë kandidatit që konkurren kërkesa konkrete, të cilat i duken të arsyeshme për një shpërfaqje sa më të mirë të tij.
- 5.4 Mbas paraqitjes së kandidatit të fundit, në mbarim të gjithë seancave që parashikohen në kriteret e konkurrimit, Komisioni i Pranimi të Programit të Studimit, nën drejtimin e Kryetarit, mbledhet për të vlerësuar një për një paraqitjet e secilit kandidat. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 5.5 Pikët e mundshme në dispozicion të Komisionit të pranimi, shpërndahen në mënyrë të barabartë tek të gjithë anëtarët e komisionit. Secili anëtar vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatit.
- 5.6 Komisioni i Pranimi të Programit të Studimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët respektive në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista në fund nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi.
- 5.7 Lista e nënshkruar si dhe shënimet e anëtarëve të komisionit të pranimi për çdo konkurrent, i dorëzohen me procesverbal titullarit të Fakultetit.
- 5.8 Komisionet e Programeve të Studimit në Fakultetin e Artit Skenik për mbarëvajtjen e konkursit marrin edhe këto masa:
 - a) **Aktrim**
Për secilin kandidat Komisioni i Pranimi të programit të studimit Aktrim xhiron me kamera njërin prej materialeve që e gjykon të arsyeshëm.
 - b) **Regji**
Komisioni depoziton në një dosje të veçantë platformën regjisoriale të gjithë kandidatëve për programin e studimit Regji. Po ashtu xhiron me kamera edhe njërin prej materialeve për secilin kandidat. Materialin e përcakton komisioni.



c) Skenografi – Kostumografi

Komisioni depoziton punimet e kryera gjatë ditëve të konkursit së bashku me dosjet personale për secilin kandidat për programin e studimit Skenografi & Kostumografi. Po ashtu depoziton në një dosje të veçantë testin teorik për secilin kandidat të sekretuar.

Në këtë specialitet komisioni e fillon punën e tij pas përfundimit të procesit të konkursit të konkurrentëve.

d) Regji Filmi dhe TV

Komisioni depoziton në një dosje të veçantë etydin regjisorial mbi baza fotografie për secilin kandidat për programin e studimit Regji Filmi dhe TV. Po ashtu depoziton në këtë dosje edhe platformën regjisoriale nga secilin kandidat gjatë konkurrimit.

e) Koreografi

Komisioni depoziton në një dosje të veçantë libretin koreografik të kandidatëve për programin e studimit Koreografi. Po ashtu xhiron me kamera edhe njërin prej materialeve koreografike që komisioni e gjykon të arsyeshëm për secilin kandidat.

5.9 Komisionet e Pranimi të Programeve të Studimit pas vlerësimeve për çdo kandidat, të gjitha dosjet dhe kasetat me materialet e mësipërme ja dorëzojnë me procesverbal sekretarisë së Fakultetit.

5.10 Kandidatët të cilët nuk fitojnë konkursin e pranimi për tu regjistruar në programin e studimit kanë të drejtën të paraqesin ankimimin e tyre me shkrim, për secilën prej fazave të konkurrimit ose për të gjitha fazat së bashku, pranë Dekanit të Fakultetit.

Dekani mund të thërrasë për sqarime komisionin/et e konkursit dhe vetë kandidatin dhe pas gjykimit të çështjes vendos: 1. shpalljen të pavlefshme të konkursit (fazës specifike ose të gjitha fazave në varësi të ankesës së kandidatit) dhe caktimin e një date tjetër për mbajtjen e fazave të kontestuara. 2. aprovimin e vlerësimit të dhënë nga komisioni dhe lënien në fuqi të tij. Vendimi i Dekanit është i formës së prerë dhe i paapelueshëm. Afatet për mbajtjen e gjithë sa më sipër përcaktohen nga Rektori i Universitetit të Arteve në përputhje me Vendimin e ministrisë së linjës për kalendarin e procedurave të aplikimit dhe regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë.

5.11 Lista përfundimtare me pikët respektive për të gjithë Programet e Studimit firmoset nga Titullari i Fakultetit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Neni 6

Shpallja e fituesve

6.1 Shpalljen e listës së renditjes provizore të rezultateve për konkursin e pranimeve për të gjitha programet e studimit të fakultetit e bën Dekani i Fakultetit.

6.2 Shpallja e fituesve bëhet duke u bazuar në Udhëzimin e MAS për zhvillimin e konkurseve të pranimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 7

Regjistrimi për të fituar statusin e studentit

- 7.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të regjistrohen për të fituar statusin e studentit.
- 7.2 Kandidatët që regjistrohen si student në Fakultetin e Artit Skenik në Universitetin e Arteve duhet të paraqesin **dokumente origjinale**. Materialet që duhet të paraqiten duhet të jenë në varësi të Udhëzimeve të MAS.
- 7.3 Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet: numri i regjistrimit, emri i kandidatit si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 7.4 Gjithashtu në këtë regjistër duhet të nënshkruajë çdo kandidat fitues, i regjistruar më parë, por që kërkon të ç'regjistrohet nga kjo degë për arsye të ndryshme.
- 7.5 Kandidatit që ç'regjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale por jo pagesa e regjistrimit.
- 7.6 Regjistrimet e kandidatëve fitues për të gjitha kuotat kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Artit Skenik, në datat që do të përcaktojë Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Neni 8

Rregulla për kandidatët

Gjatë konkursit, kandidati duhet të respektojë këto rregulla:

- 8.1 Kandidatët duhet të paraqiten në Fakultet ditën e parë të fillimit të konkursit në orën e përcaktuar në kalendarin e zhvillimit të konkurseve i shpallur në Fakultetin e Artit Skenik.
- 8.2 Kandidati do të paraqitet para Komisionit të Pranimi të Programit të Studimit në bazë të orarit që do të përcaktojë Komisioni i Programit të Studimit.
- 8.3 Mosparaqitja në bazë të këtij orari çon në s'kualifikimin e tij nga konkursi.
- 8.4 Nëse ka kandidatë që konkurrojnë në dy ose më shumë programe studimi dhe konkursi zhvillohet në të njëjtën kohë atëherë kandidati paraqet një kërkesë me shkrim te dekani i fakultetit për ti mundësuar paraqitjen në të gjitha konkurrimet. Për këtë dekani koordinon punën me kryetarët e komisioneve dhe kandidatit i krijohet mundësia e paraqitjes në konkurs në kohë të ndryshme.
- 8.5 Kandidati duhet të shpërfaqë para Komisionit kërkesat që rrjedhin nga kriteret për çdo Program Studimi.
- 8.6 Nuk lejohet përdorimi i celularëve apo objekti tjetër pa miratimin e komisionit.
- 8.7 Nga ana tjetër komisioni krijon atmosferën e nevojshme që kandidati të shpreh aftësitë e tij.
- 8.8 Kandidati do të largohet nga konkurrimi vetëm kur komisioni t'ia kërkojë këtë gjë.

DEPARTAMENTI AKTRIM DHE TEORI

Prof. Gazmend GJOKA

DEPARTAMENTI SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI, KOREOGRAFI


Prof.asoc.Taulant PUSTINA

DEPARTAMENTI REGJI, REGJI FILMI DHE TELEVIZIONI

Prof.asoc. Alert ÇELOALIAJ

ZV/DEKANI TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK

Dr. Elis MATAJ



DEKANI

Prof. Miltiadh KUTALI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

R R E G U L L O R E

PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT

NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË

“MASTER I ARTEVE DHE MESUESI ”

NË FAKULTETIN E ARTIT SKENIK,

NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

PËR VITIN AKADEMIK 2027 – 2028

MIRATUAR ME VENDIM NR 14, DATË 02/03/2026
TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Arsimit të Lartë, në Republikën e Shqipërisë”, Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 76, “*Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve*”, si dhe mbështetur në Rregulloren e UART të ciklit të dytë të studimeve, konkurset e pranimit në Fakultetin e Artit Skenik për vitin akademik 2027-2028 do të zhvillohen si më poshtë:

Neni 1

Pranimi i kandidatëve

- 1.1 Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Artit Skenik në Universitetin e Arteve, bëhet me konkurs mbi bazën e rezultateve të konkurseve që zhvillohen për studimet në ciklin e dytë të studimeve “Master i Arteve” pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit sipas kësaj rregulloreje si dhe kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 1.2 Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta “Për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja”, do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3 Përzgjedhja e tyre është e ndërvarur nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit Sportit, posaçërisht për trojet Shqiptare.
- 1.4 Kandidatë për program të dytë studimi.

Neni 2

Kriteret e pranimit

- 2.1 Pranimi në programet e ciklit të dytë MASTER I ARTEVE DHE MESUESI është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe zotërojnë diplomën BACHELOR.
- 2.2 Kandidatët mund të kenë kryer programin e studimit të ciklit të parë Bachelor pranë këtij fakulteti ose në Fakultete të tjera si brenda dhe jashtë vendit.
- 2.3 Pranohen të gjithë ata kandidatë që kanë kryer studimet në ciklin 4-vjeçar në fakultetin e Artit Skenik. Gjithashtu edhe ato kandidatë të ciklit 4-vjeçar, të fakulteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- 2.4 Nota mesatare e kandidatëve preferohet të jetë mbi 7 (e ponderuar)
- 2.5 Për konkurrentët që kanë kryer studime jashtë vendit duhet bërë paraprakisht njehsimi i Diplomës në strukturat përkatëse të MAS.
- 2.6 Baza e konkurimit për kandidatët në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Artit Skenik për studime në ciklin e dytë të studimeve “Master i Arteve dhe Mësuesi”, janë kriteret e miratuara nga departamentet përkatëse si dhe nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 2.7 Konkurimi për këtë cikël studimesh ka në bazë **dy faza**:
Faza e parë: *shqyrtimi i dosjes së kandidatit*.
Faza e dytë: *bashkëbisedim me kandidatët*.



2.8 Kandidatët për programin e studimit “Master i Arteve dhe mësuesi”, për vlerësimin e Fazës së parë duhet të dorëzojnë pranë Fakultetit të Artit Skenik, dosjen personale të konkurrentit ku të jenë të përfshira:

- I. CV e tij/e saj,
- II. Diploma Bachelor ose e sistemit 4 vjeçar,
- III. Lista origjinale e notave të programit të studimit të kryer,
- IV. Dëshmi mbi rezultatet e arritura në procesin e realizimit të programit mësimor,
- V. Projekte,
- VI. Shfaqje,
- VII. Filma,
- VIII. Ekspozita, etj.

2.9 Dosja duhet të përmbajë dëshmitë e aktiviteteve artistike, si brenda dhe jashtë shkollës:

- I. Postera,
- II. Fletë palosje,
- III. Fotografi,
- IV. Dhe çdo material tjetër që dëshmon aktivitetet artistike të konkurrentit.

2.10 Kandidatët që kanë kryer programe të tjera studimi, jashtë Fakultetit të Artit Skenik, brenda dhe jashtë vendit do të kenë dhe një intervistë me komisionin e pranimi.

2.11 Për çdo sqarim tjetër në lidhje me konkursin, programet e studimit si dhe me plotësimin e krediteve, drejtoheni pranë Fakultetit të Artit Skenik.

Neni 3

Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

- 3.1 Dekani i Fakultetit, mbështetur në propozimet e Përgjegjësve të Njësive Bazë, merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Pranimi për çdo program e Studimi.
- 3.2 Përbërja e Komisionit të Pranimi të Programit të Studimit shpallet në ditën e fillimit të konkursit.
- 3.3 Në përbërjen të Komisionit të Pranimi aktivizohen:
 - I. Titullarë të fushës përkatëse,
 - II. Pedagogë efektivë të Departamenteve përkatëse,
 - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës për ato programe studimi ku nuk mund të mbulohen nga pikat I, II të këtij neni.
- 3.4 Në përbërjen të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë bërë konsultime private lidhur me konkursin e pranimi apo janë në konflikt interesi.
- 3.5 Në ambientet ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga Titullari i Fakultetit të Artit Skenik .
- 3.6 Për monitorimin e të gjithë procedurave të konkurrimit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, Rektori i UART, me Urdhër të posaçëm ngre grupin përkatës, i cili monitoron cilësinë e zhvillimit të gjithë procedurave të konkurrimit në Fakultetin e Artit Skenik. Po ashtu konkursi monitorohet dhe nga përfaqësuesit e MAS.



Neni 4
REPUBLICA E SHQIPËRISË
Procedura e konkurrimit.

- 4.1 Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurs të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e Nenit 2, të kësaj rregulloreje.
- 4.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët që janë regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Artit Skenik, brenda afatit të përcaktuar nga MASR.
- 4.3 Konkursi për Fakultetin e Artit Skenik do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit, sipas udhëzimeve të MASR.
- 4.4 Komisionet e pranimit do të marrin në shqyrtim vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurrim nga sekretaria mësimore.
- 4.5 Në momentin e regjistrimit kandidati duhet të paraqesë:
 - I. *Kartë Identiteti,*
 - II. *Pasaportë për jashtë shteti.*
 - III. *Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente identifikimi nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.*
- 4.6 Kandidati konkurrent për të hyrë në konkurs duhet të ketë bërë pagesën e përcaktuar, në llogari të Universitetit të Arteve. Kjo e bazuar në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- 4.7 Në varësi të numrit të kandidatëve për secilin Program Studimi komisionet do të punojnë paradite dhe pasdite. Oraret bëhen të ditura më parë dhe shpallen në ambientet e Fakultetit.
- 4.8 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe ambientet e zhvillimit të tyre do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve në ambientet e Fakultetit të Artit Skenik.
- 4.9 Sekretaria mësimore ju dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të Programit të Studimit të gjitha materialet për konkurs, dosjet përkatëse si dhe listat e konkurrentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 4.10 Bazuar në kriteret për secilin Program Studimi, komisionet kur e shohin të nevojshme krijojnë tërë hapësirën kohore të nevojshme për shpërfaqjen individuale të kandidatëve.

Neni 5
Mënyra e Vlerësimit

- 5.1 Vlerësimi maksimal për çdo konkurrent është gjithsej **100 pikë**.
- 5.2 Vlerësimi maksimal i Fazës së I të konkurrimit :
 - Nota mesatare e ponderuar **30 pikë**
 - Shqyrtimi i dosjes personale **30 pikë**
- 5.3 Vlerësimi maksimal i Fazës së dytë të konkurrimit bashkëbisedim me kandidatët është **40 pikë**.
- 5.4 Pikët minimale që duhet të marrë një konkurrent për t'u pranuar si fitues në ciklin e dytë të studimeve Master, **janë 40** (dyzetë) pikë.

Neni 6
Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

- 6.1 Vlerësimi për paraqitjen individuale të çdo kandidati bëhet nga Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohen nga titullari i Fakultetit.
- 6.2 Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjatë shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve anëtarët e jurisë mbajnë shënimet përkatëse. Po ashtu çdo anëtar i jurisë gjatë fazës së bashkëbisedimit ka të drejtë t'i drejtojë kandidatit që konkurren pyetje konkrete, të cilat i duken të arsyeshme për një shpërfaqje sa më të mirë të tij.

- 6.3 Në mbarim të gjithë seancave që parashikohen në kriteret e konkurrimit, Komisioni i Pranimi të Programit të Studimit, nën drejtimin e Kryetarit, mblidhet për të vlerësuar një për një paraqitjet e secilit kandidat. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 6.4 Pikët maksimale për vlerësim janë 100.
- 6.5 Pikët minimale që kandidati të shpallet fitues janë 40 pikë.
- 6.6 Secili anëtar i komisionit të pranimi vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatit.
- 6.7 Komisioni i Pranimi të Programit të Studimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët respektive në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista në fund nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi.
- 6.8 Lista e nënshkruar si dhe shënimet e anëtarëve të komisionit të pranimi për çdo konkurrent, i dorëzohen me procesverbal titullarit të Fakultetit. Komisionet e Pranimi të Programit të Studimit pas vlerësimeve për çdo kandidat, të gjitha dosjet dhe kasetat me materialet e mësipërme ja dorëzojnë me procesverbal në sekretarinë e Fakultetit.
- 6.9 Lista përfundimtare me pikët respektive për të gjithë Programet e Studimit firmosen nga Titullari i Fakultetit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit Sportit.
- 6.10 Kandidatët të cilët nuk fitojnë konkursin e pranimi për tu regjistruar në programin e studimit kanë të drejtën të paraqesin ankimimin e tyre me shkrim, për secilën prej fazave të konkurrimit ose për të gjitha fazat së bashku, pranë Dekanit të Fakultetit. Dekani mund të thërrasë për sqarime komisionet e konkursit dhe vetë kandidatin dhe pas gjykimit të çështjes vendos: 1. shpalljen të pavlefshme të konkursit (fazës specifike ose të gjitha fazave në varësi të ankesës së kandidatit) dhe caktimin e një date tjetër për mbajtjen e fazave të kontestuara. 2. aprovimin e vlerësimit të dhënë nga komisioni dhe lënien në fuqi të tij. Vendimi i Dekanit është i formës së prerë dhe i paapelueshëm. Afatet për mbajtjen e gjithë sa më sipër përcaktohen nga Rektori i Universitetit të Arteve në përputhje me Vendimin e ministrisë së linjës për kalendarin e procedurave të aplikimit dhe regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Neni 7

Shpallja e fituesve

- 7.1 Shpalljen përfundimtare për fituesit e bën Dekani i Fakultetit mbi bazën e kuotave të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 7.2 Në rastin kur disa konkurren kanë fituar të njëjtin numër pikësh, ata renditen midis tyre duke marrë si bazë notën mesatare të ponderuar.

Neni 8

Regjistrimi për të fituar statusin e studentit

- 8.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të regjistrohen për të fituar statusin e studentit.
- 8.2 Kandidatët që regjistrohen si student në Universitetin e Arteve duhet të paraqesin **dokumente origjinale**.
- 8.3 Ato duhet të jenë:
I. Diploma Bachelor

- II. Për kandidatët shqiptarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dokumentet e mësipërme duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe e të noteruara.
 - III. Kartë identiteti,
 - IV. Pasaportë,
 - V. 2 (dy) fotografi
 - VI. Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit që caktohet nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.
- 8.4 Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet: numri i regjistrimit, emri i kandidatit si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 8.5 Gjithashtu në këtë regjistër duhet të nënshkruajë çdo kandidat fitues, i regjistruar më parë, por që kërkon të ç'registrohet nga kjo degë për arsye të ndryshme.
- 8.6 Kandidatit që çregjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale por jo pagesa e regjistrimit.
- 8.7 Regjistrimet e kandidatëve fitues për të gjitha kuotat kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Artit Skenik, në datat që do të përcaktojë Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë.

Neni 9 **Rregulla për kandidatët**

Gjatë konkursit, kandidati duhet të respektojë këto rregulla:

- 9.1 Kandidatët duhet të paraqiten në Fakultet ditën e parë të fillimit të konkursit në orën e përcaktuar në kalendarin e zhvillimit të konkurseve i shpallur në Fakultetin e Artit Skenik.
- 9.2 Kandidati do të paraqitet para Komisionit të Pranimi të Programit të Studimit në bazë të orarit që do të përcaktojë Komisioni i Programit të Studimit. Mosparaqitja në bazë të këtij orari çon në s'kualifikimin e tij nga konkursi.
- 9.3 Nuk lejohet përdorimi i celularëve.
- 9.4 Komisioni krijon atmosferën e nevojshme që kandidati të shpreh aftësitë e tij.
- 9.5 Kandidati do të largohet nga konkurrimi vetëm kur komisioni t'ia kërkojë këtë gjë.

DEPARTAMENTI AKTRIM DHE TEORI

Prof. Gazmend GJOKA

DEPARTAMENTI SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI, KOREOGRAFI

Prof.asoc.Taulant PUSTINA

DEPARTAMENTI REGJI, REGJI FILMI DHE TELEVISIONI

Prof.asoc. Alert ÇELOALIAJ

ZV/DEKANI TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK

Dr. Elis MATAJ

DEKANI
Prof. Miltiadh KUTALI

